



VENDIM

Nr. 30 Datë 26.03.2012

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SH.A NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 14, pika 1, germa “a”, si dhe të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror.” neni 4, pika 1, germa “a”; neni 8, neni 9 pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “a” dhe nenin 10, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 09, date 11.02.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.03.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL sha”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “ALBPETROL sha”, për liçensimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ALBPETROL sha” në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.
2. Ngarkohet Drejtorja e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.